



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 13040 Prot.

Tiranë, më 26.12. 2018

**UDHËZIM**

NR. 38, DATË 26.12. 2018

**PËR**

**DATAT DHE ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2019**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2019 të jenë:

a) Gjuhë e huaj	07 qershor 2019
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi	12 qershor 2019
c) Matematikë	17 qershor 2019
d) Provimi me zgjedhje	24 qershor 2019
  
2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2019, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, miratuar me Urdhrin nr.780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
  
3. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, të përcaktojnë testin për secilin provim të Maturës Shtetërore .
  
4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019:
  - 4.1 Fillojnë në orën 10:00.
  - 4.2 Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
  - 4.3 Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja.

- 4.4 Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë maksimale.
- 4.5 Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, rijapin provimet në sesionin e dytë.
5. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018-2019, dhe brenda datës 5 qershor 2019, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online, sipas udhëzimit përkatës. Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.
- 5.1 Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2019, pa likuiduar më parë provimet e klasës.
- 5.2 Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.02.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë".
- 5.3 Testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.
- 5.4 Testi i provimit "Gjuhë frënge" (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.
- 5.5 Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2019 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga MASR-ja. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit paktohen për çdo qendër më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë.
- 5.6 Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2019 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".*

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

